

## E drejta e qasjes në kujdesin shëndetësorë e Komunitetit Boshnjak në Regjionin e Zhupës, Prizren

---

### Hyrje

Në vitin 2018, **Asistenti ligjorë i ERAC** identifikoi një rast ku e drejta për qasje dhe për të marrë kujdesin shëndetësor është shkelur. Regjioni i Zhupës, i vendosur në Komunën e Prizrenit, i banuar nga një shumicë e komunitetit boshnjak. Regjioni ka vuajtur nga mungesa e shërbimeve shëndetësore publike. Në këtë regjion ka 9 Qendra Emergjente të Ambulancës (QEA), 1 Qendër Mjekësore Familjare (QMF) dhe 1 Laborator Mjekësor. Asistenti ligjorë i ERAC e hetoi rastin dhe vizitoi fshatrat në regjionin e Zhupës për të marrë më shumë informata dhe për të parë se cilat masa janë ndërmarrë nga autoritetet lokale.

### Procesi lidhur me rastin

Gjatë vizitës së tij, Asistenti ligjorë, zbuloi se qendrat mjekësore ishin vetëm pjesërisht funksionale dhe mungonin punonjësit, duke rezultuar në shërbime shëndetësore të parregullta. Ka rreth 11,000 njerëz që jetojnë në rajonin e Zhupës në 15 fshatra: Sredska, Pousko, Jablanica, Lokvica, Rečane, Živinjane, Planjane, Nebregošte, Manastiricë, Struge, Donje Ljubinjje, Gornje Ljubinjje, Dražčići, Mušnikovo, Gornje Selo. Banorët e këtyre fshatrave lënë të kuptohet që disa fshatra vizitohen nga mjeku vetëm një herë, herë pas here dy herë, një javë dhe tri herë në javë nga një teknik mjekësor i cili vjen pa orarë, por me orë të rastësishme të punës. Në fshatrat më pak të populluara, nuk ka as QEA as automjete ambulance për të sjellë pacientët në QMF, e cila ndodhet në fshatin Rečan, duke e bërë të vështirë për ata që nuk posedojnë vetura personale për të vizituar QEA.

Megjithatë, Asistenti ligjorë i ERAC raportoi se ka 5 mjekë dhe 8 teknikë mjekësorë që jetojnë në këtë rajon, por që nuk janë të punësuar. Fuqia punëtore është e disponueshme; megjithatë, problemi ishte me burimet financiare të alokuara për rajonin nga administrata komunale.

Drejtorja e Departamentit të Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit është kontaktuar përmes postës elektronike dhe u janë dërguar disa pyetje për të marrë më shumë informacion lidhur me këtë rast. Për më tepër, Asistenti ligjorë i ERAC u takua me Drejtorin

e Shëndetësisë dhe çështja u ngrit edhe në Kuvendin Komunal të Prizrenit. Një ekip nga drejtorja e shëndetit e komunës vizitoi rajonin për të vlerësuar kushtet. Bazuar në nevojat urgjente, situata u lehtësua kur Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhuroi një automjet të ambulancës në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Zhupë.<sup>1</sup>

### **Korniza ligjore dhe konsideratat tjera**

Shpërndarja e mjeteve mjekësore në Kosovë kryhet përmes kornizës ligjore të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës.<sup>2</sup> Pjesa kryesore e kësaj kornize është Ligji për Shëndetësinë Nr. 04 / L-125<sup>3</sup> dhe Udhëzimi Administrativ (shëndeti) Nr. 08/2017<sup>4</sup>. Ku sipas të dyjave, siç është përcaktuar në ligj dhe në udhëzimin administrativ, rasti në rajonin e Zhupës ishte në kundërshtim me të drejtën themelore për shëndetin dhe mbrojtjen sociale.<sup>5</sup>

### **Rezultatet:**

Asistenti ligjorë ka monitoruar këtë rast dhe si rezultat i përpjekjeve të tij së bashku me përfaqësuesit e komunitetit boshnjak, Drejtorja e Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit ka punësuar një mjek që punon tri herë në javë, infermieret dhe teknikët që punojnë çdo ditë të javës në QMF. Gjithashtu një laborator mjekësor u rihap në nëntor 2018 që ishte mbyllur në vitin 2014.

### **Rekomandimet:**

Kërkohet mbikëqyrje më e shpeshtë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga Ministria e Shëndetësisë. Për më tepër, njerëzit duhet të kërkojnë të drejtat e tyre për qasje në kujdesin shëndetësor në rast se ata mendojnë se janë duke u privuar nga e drejta e tyre:

- duke paraqitur një ankesë, duke iu referuar të drejtave kushtetuese dhe ligjeve përkatëse
- dërgoni në komunat përkatëse; Drejtorisë së Shëndetësisë
- ngritni çështjen në mesin e përfaqësuesve tuaj në kuvendin e komunës
- Nëse është e nevojshme, dërgoni rastin tek Ministria e Shëndetësisë
- Që të fitoni përkrahje për rastin tuaj, ju rekomandojmë që të kontaktoni Zyren tuaj rajonale të Avokatit të Popullit.

<sup>1</sup> <https://kallxo.com/ministria-e-shendetesise-dhuron-dy-autoambulanca/>

<sup>2</sup> <https://msh.rks-gov.net/>

<sup>3</sup> <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20Health.pdf>

<sup>4</sup> <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/01/Udhezim-Administrativ-08-2017.pdf>

<sup>5</sup> <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>